
	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

KOSTT

Raport Vjetor 2010


(01.01.2010-31.12.2010)

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Shpresa Kursani	Fadil Ismajli KSHE	Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	<i>Janar -Shkurt 2011</i>		

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 49</i>
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2010

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2010
2	Dërguesi i dokumentit	Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Kapitulli 1: Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë vitit 2010</p> <p>Kapitulli 2: Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare</p> <p>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Teknik të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit</p> <p>2.2. Raport i operimit të tregut</p> <p>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT</p> <p>2.4. Çështjet Rregullative</p> <p>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare</p> <p>2.5.1 Draft Pasqyrat financiare (Bilanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë vitit 2010)</p> <p>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>Kapitulli 3 : Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>Kapitulli 4: Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2010 nga burimet e KOSTT</p> <p>Shtojcë 1: Aktivitetet e posaçme</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Hyrje


Raporti Vjetor i vitit 2010 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2010 si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit, të arriturat/dështimet e departamenteve, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet aktivitetet e posaçme të KOSTT gjatë periudhës raportuese.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nenin 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2010

1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit. Përbëhet nga afarizmi themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet si:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, zhvillimor, komercial, rregullativ, ligjor, si dhe administrativ, që zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:


- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat dhe
- Burimet Njerëzore

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Planifikim Strategjik dhe Buxhet
- Zyra për Prokurim
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mbrojtje nga Zjarri

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 7 (shtatë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT gjithashtu janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizim aktual i KOSTT-it është paraqitë në Makro Strukturën Organizative e cila ka pësua një ndryshim në periudhën e fundit të këtij viti. Ndryshimet përbëjnë kryesisht

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

kërkesat e bazuara në Statutin e KOSTT-it dhe Ligjin për Ndërmarrje Publike, ku përfshihen kërkesat për emërtime përkatëse të Zyrtarëve në KOSTT.

1.2. Numri i Punëtorëve

Numri i punëtorëve me 1 janar 2010 ishte **218**. Deri në fund të tremujorit të dytë ka pësuar lëvizje dhe numri i punëtorëve është zvogëluar në 216, ndërsa në fund të tremujorit të tretë ka rënë në 214. Më 31 dhjetor 2010 numri i të punësuarve ka rënë në 213, për shkak të shkuarjes së një punëtoreje në pushim pa pagesë pas pushimit të lehonisë. Pra, numri i punëtorëve aktiv , përfundimisht më 31 dhjetor 2010 është 213.

Arsye e zvoglimit të numrit të punëtorëve gjatë vitit (tremujori i dytë dhe i tretë) ishte:

- pensionimi i një (1) punëtori
- dy (2) punëtorë kanë ndërruar jetë
- 1 (një) punëtori i është shkëputur marrëdhënia e punës me kërkesën e tij

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative e KOSTT-it, përfundimisht me 31 dhjetor 2010.




RAPORT VJETOR

ver. 1.0

DT-PB-004

faqe 6 nga 49

Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave



	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 49</i>
Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave		

Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare

2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës


2.1.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për janar- dhjetor 2010

Muajt (MWh)	Janar - Dhjetor 2010		
	E planifikuar	E realizuar	real/plan. %
(1) TC Kosova A	1 410 360	1 739 815	123.36
(2) TC Kosova B	3 238 194	3 270 605	101.00
(3) HC Ujmani	68 000	113 861	167.44
(4) Lumbardhi	24 502	36 083	147.26
5= 1+2+3 Total Prodhimi	4 716 554	5 124 281	108.64
(6) Devijimi		- 4 007	
(7) Eksporti		352 471	
(8) Importi	813 940	818 387	100.55
9= 5-6+8-7 Energjia në disponim	5 530 494	5 594 204	101.21
(10) Distribucioni	4 312 690	4 432 327	102.77
(11) Ferronikeli	629 112	621 073	98.72
(12) Trepça	29 000	21 217	73.16
(13) Sharri	61 000	59 757	97.96
(14) Mihjet, Kos.thëngj, NS Palaj, gjenerim konsum.e jasht.KEK, LP 290	145 580	328 785	225.85
15= 10+11+12+13+14 Konsumi neto	5 177 382	5 463 159	105.52
(16) Humbjet në transmision	197 267	131 044	66.43
17= 15+16 Konsumi bruto	5 374 649	5 594 203	104.08
Ngarkesa maksimale MW	1020	1156	113.33


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		


Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:

Bilanci i planifikuar 2010





Bilanci i realizuar 2010



	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Diagrami i bilancit të realizuar elektroenergjetik 2010 (GWh)



	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit


Nr	Indikatori		2009	2010	2010/2009(%)	Caku	Komenti
			Janar-Dhjetor 2009	Janar-Dhjetor 2010			
T1	Energjia e transmetuar (GWh)		8349,59	8707,43	104,29	Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision	Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 4.29 % është transmetuar energji më shumë në vitin 2010 se sa 2009.
T2	Piku koincident (MW)		1072	1156	107,84	Caku: 1020MW (Sipas Bilancit Elektroenergjetik 2010).	Piku për 7.84 % është më i lartë në vitin 2010 në krahasim me 2009, gjë që tregon rritjen e mundësive transmetuese.
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	380 kV	181,81	181,8	100,00	= > 1	Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit.
		220 kV	231,88	231,8	100,00		
		110 kV	672,10	727,6	108,26		

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

T4	MVA-km	380 kV	239450	239450	100,00	= > 1	Caku është si në T3
		220 kV	77506	77506	100,00		
		110 kV	78279	80573	102,93		
T5	Kapaciteti i transformatorëve	380-220/110 kV	1500	1500	100,00	= > 1	Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.
		220-110 kV	1050	1050	100,00		
T6	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T7	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T8	Pagesa për kongestion						KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.
T9	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)		771,96	230,25	29,83	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për vitin actual)/(AIT për vitin e kaluar) < 1	AIT është për 70.17% më e vogël në 2010 se sa në 2009, e që është një performance shumë e mirë e sistemit.
T10	Numri i ankesave për tension		23	8	34,78	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për ankesa të tensionit duhet të ndërlihet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak(e). Është për 65.22% më e favorshme në krahasim me vitin paraprak.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	23	8	34,78	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraparak(e).
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
T12	Numri i ankesave për matje		0	0			
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë	0	0		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	10,94	17,84	163,05	20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla. Gjatë vitit 2010, kjo vlerë ka qenë më e madhe, për
		Ekспорт	12,38	15,53	125,45	20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		


							shkak të moskompletimit të prijektit SCADA.
T15	Humbjet në transmision (GWh)		174,57	131,04	75,07	Humbjet e aprovuara nga ZRRE, 166GWh	Humbjet janë për 24.93% më të vogla në 2010 se sa në 2009. Caku është që humbjet të jenë sa më të vogla.

$$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektor:</i>

2.1.4. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit


Nr	Indikatori	Niveli i tensionit	2009	2010	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV	Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	2010/2009 (%)	< = 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.43	0.00	0		
		110	1.89	1.38	73.01587302		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	0	0	> 1	Është e ndikuar nga linja 126/4 e cila kyçet në NS Vallaqi. Niveli dhe forma e sigurisë në pjesën veriore të vendit kanë ndikuar në vonesën e qasjes, identifikimit dhe evitimit të prishjes.
		220	0.63	0	0		
		110	3.55	5.34	150.4225352		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

		110	0.10	0.00	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformatorë (njësi)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	11.10	0.00	0		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformatorë (orë)	400/220(110)	0.00	0	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.08	0	0		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	1.60	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	1.00	0.00	0		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancëpozitive
		220	13.26	0.00	0		
		110	5.39	4.88	90.5380		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0	0	> 1	Për nivelin e tensionit 110 kV kemi një tejkallim të caktit i cili ka ndodhur për shkak të avarisë në NS Prishtina 4 me datë 13.06.2010.
		220	1.33	0	0		
		110	0.81	3.71	149.5833		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	2.40	3.59	149.5833		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0		Për shkak te avarisë në NS Prizreni 1
		220	2.77	5.54	200		

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

		110	5.70	6.40	112.2807		dhe NS Prishtina 4
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.00	0	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.33	3	923.07		
		110	0.80	6.29	786.25		
T12	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 49</i>
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

2.2. Raport mbi operimin e tregut


Raporti përmbanë informata rreth madhësisë së tregut, pjesës së rregulluar dhe të parrregulluar, çmimin e arritur si mesatare e ponderuar me energjinë, në tregun me shumicë si dhe për integrimin e KOSTT në asociacionet dhe mekanizmat regjional

2.2.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të parrregulluar.

Në tabelë janë dhanë palët e licencuara që veprojnë në treg të energjisë elektrike në Kosovë:


Palët në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë				
	Operatorë	Gjenerator	Furnizues	Tregtim ndërkufitar
1	KOSTT- Operatori i Tregut të Energjisë	KEK - TC Kosova-A	KEK - Furnizim Publik me Energji Elektrike	KEK - furnizim / tregtim me Energji Elektrike
2	KOSTT- Operatori i Sistemit të Transmisionit	KEK - TC Kosova-B		New kosovo energy LLC (përfaqësia e CEZ a.s.)
3	KEK-Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	N.P Ibër-Lepenc		Energy Finacing Team" AG, ("EFT")
4		KelKos Energy" SH.P.K		Ezpad S.R.O
5				Rudnap Group A.D.
6				Grupi i Sistemve Automatike SH.P.K
7				Korela Invest A.S
8				"AKIDU" D.o.o Përfaqësia në Kosovë
9				"EGL d.o.o.Beograd"-("EGL")
10				"ALPIQ ENERGIJA RS"
11				"GEN-I Tirana Sh.p.k"
12				'Repower Trading Česka Republica s.r.o.'

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar Feronikeli furnizohet nga furnizuesi publik me çmim të parregulluar. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të pa-rregulluar paraqitet si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmissioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit. Konsumi tarifor (pa Feronikelin) në nivel me pakicë në Janar-Dhjetor '10 ishte mesatarisht rreth 83.00% të konsumit të përgjithshëm bruto (duke mos përfshirë humbjet në transmission).

Në Fig. 1 është paraqitur figurativisht madhësia e tregut të rregulluar (tarifor) në raport me tregun e parregulluar. Konsumi i KEK nga rrjeti i transmissioinit për nevoja vetjake, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor është i paraqitur gjithashtu në figurë.


Fig.1 Tregut tarifor dhe jo tarifor në raport me konsumin



Në Fig 2. është paraqitë bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT. Si shihet mbi 30% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale, dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 49</i>
Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave		

Fig 2. Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues për vitin 2010




Në Tab. 2 janë dhënë çmimet e rregulluara dhe të parregulluara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë. Çmimet e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë janë marrë nga modelet tarifore 2008, 2009, 2010.

Në çmimin mesatar të sistemit ndikon dukshëm sasia e importit dhe çmimi i tij. Si shihet nga tabela çmimi i importit të energjisë elektrike ka pasur rënie dhe si pasojë edhe çmimi i ponderuar i energjisë elektrike ka pasur rënie nga viti 2008 deri në vitin 2010.

Tab. 2. Çmimet e rregulluara dhe të parregulluara të energjisë elektrike

		2008	2009	2010
		€/MWh	€/MWh	€/MWh
Çmimet e rregulluara	Kosova B	19.42	23.32	23.35
	Kosova A	19.42	23.32	23.35
	HC Ujmani	24	24	27.4
	HC Lumbardhi	40	40	40
Çmimet e parregulluara	Importi - çmimi mesatar	112,5	75,89	57,95
	Eksporti - çmimi mesatar	36,59	20,17	26,45
Çmimi mesatar i ponderuar i sistemit		27,96	25,78	24,15

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

2.2.2. Integrimi i KOSTT në asociacionet dhe mekanizmat regional

- **Anëtarësimi**

KOSTT është:

1. Vëzhgues në RG SEE¹
 - a. Vëzhgues në SG CMMI²

Kjo pozitë e vëzhguesit, pa të drejtë vote, është duke e vështirësuar procesin drejt integritit të KOSTT në mekanizmat regional përkundër rezultateve të arritura gjatë viteve paraprake
2. Antar i CAO IG³
3. Anëtr i PSC⁴

Kosova si nënshkruese e traktatit, përmes KOSTT si TSO e sajë, duhet të përmbush obligimet që dalin nga Rregullorja 1228/2003 që ka të bëjnë me tregëtimin ndërkufitar dhe në veçanti me tranzitin e energjisë elektrike dhe alokimin e kapaciteteve interkonektive. Në përmbushjen e këtyre obligimeve edhe integrimin në mekanizmat regional KOSTT edhe më tutje është duke u penguar nga EMS – TSO e Serbisë.

Një nga objektivat kryesore të KOSTT është anëtarësimi në ENTSO-E. Për këtë qëllim KOSTT edhe gjatë vitit 2010 ka ndërmarrë një mori aktivitete për ta përmbushur këtë objektive. KOSTT është duke punuar në plotësimin e kushteve dhe standardeve që duhet plotësuar për anëtarësim në ENTSO-E dhe ka zhvilluar procedurat e nevojshme të parapara me UCTE OH⁵. Në muajin Korrik 2009 përfaqësuesit e KOSTT kanë mbajtur një takim në Komisionin Evropian (DG TREN) dhe në ENTSO-E ku janë diskutuar problemet dhe vështirësitë e integritit të KOSTT në mekanizmat regional dhe anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E. Në takimin e mbajtur në ENTSO-E përfaqësuesi i Komisionit Evropian deklaroi se nuk ka pengesa legale që KOSTT të anëtarësohet në ENTSO-E dhe për më tepër KOSTT si TSO e palës kontraktuese e komunitetit të energjisë duhet të përmbushë obligimet që dalin nga legjislacioni Evropian.


¹ RG SEE është grup regional në ombrellën e MC –Market Committee – Komiteti i tregut i ENTSO-E dhe i cili do të merret me çështjet e tregut në EJM

² Njëgrup I RG SEE për menaxhimin e kongjestionëve dhe integrimin e tregut

³ CAO IG Coordinated Auction Office Implementation Group – Grupi Implementues për themelimin e Zyrës regionale për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve

⁴ Komiteti drejtues i ekipit të projektit që ka për detyrë të bëjë përgatitjet për themelimin e zyrës për alokim të koordinuar

⁵ UCTE OH – Operational handbook – përbledhje e principeve dhe rregullave që duhet të zbatohen TSO-të e Evropës për operimin e sistemeve elektroenergetike

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

- **Ankesa e KOSTT ndaj Serbisë**

Ankesa formale e KOSTT e dorëzuar në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në gusht 2008, kundër Serbisë si palë kontraktuese dhe që i referohet shkeljes së provizioneve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë nga Serbia në implementimin e Rregullores 1228/2003 për qasje në rrjet dhe tregti ndërkufitare, është në procedurë e sipër dhe së shpejti pritet që rasti të procedohet në Këshillin Ministror.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka ndërmjetësuar tri takime mes KOSTT dhe MEM/EMS të Serbisë me qëllim të zgjidhjes së kontestit në mënyrë bilaterale por kanë përfunduar pa ndonjë marrëveshje.


Në shtator 2010 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka dërguar letër të hapur Serbisë në të cilën shpreh mendim preliminar se Serbia përmes operatorit të sajë është duke bërë shkelje të Traktatit duke mos njohur përbërjen gjeografike të Komunitetit të Energjisë e që ka të bëj me Rregulloren 1228/2003.

Në nëntor 2010 Serbia në përgjigjen dërguar Sekretariatit hedhë poshtë mendimin preliminar duke akuzuar Sekretariatit se ka bërë shkelje të procedurave për konteste dhe se ajo nuk është duke bërë shkelje pasi që ajo është përgjegjëse për tërë territorin e Serbisë përfshirë Kosovën. Me mosnjohjen e KOSTT, Serbia e dëshmon edhe një herë se është duke bërë shkelje të Traktatit, që ka të bëj me përbërjen gjeografike të Komunitetit të Energjisë.

- **Marrëveshja shumëpalëshe e ITC**

Kompensimi i tranzitit të energjisë elektrike deri me tani është bazuar në mekanizmin e ITC dhe marrëveshjes vullnetare të TSO-ve të Evropës. KOSTT që në fillim të këtij mekanizmi, në vitin 2006, ka shprehur gatishmërinë të jetë pjesë e këtij mekanizmi dhe të nënshkruaj marrëveshjen për ITC, por për shkak të obstrukcioneve të Serbisë ka mbetur jashtë këtij mekanizmi, ndërsa EMS asetet e KOSTT i ka paraqitur si të vetat. Na është sugjeruar se me nxjerrjen e rregullores për ITC nuk do të ketë më marrëveshje vullnetare por kjo do të jetë obligative. Me nxjerrjen e Rregullores 774/2010 të KE që ka të bëj me ITC i jemi drejtuar ENTSO-E për përfshirjen e KOSTT në ITC. Përgjigja e ENTSO—E në letrën e dërguar KOSTT ishte se përfshirja e KOSTT në marrëveshjen e ITC nuk mund të bëhet para zgjidhjes së kontestit me Serbinë.

Me 23 Shkurt 2011 sërish i jemi drejtuar ENTSO-E , Komisionit Evropian dhe Sekretariatit për shqetësimin tonë rreth nënshkrimit të marrëveshjes multilaterale të ITC që do të hyjë në fuqi në Mars 2011. Në këtë letër KOSTT përsëri ka shprehë gatishmërinë të jetë nënshkrues i kësaj marrëveshje por nëse nuk do të jetë, atëherë asetet e KOSTT të mos përfshihen si asetet e Serbisë.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		

2.1. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

Projektet	Vlera e kontratës	Total deri me 31.12.2009	Realizimi 2010 BK + donacion + KOSTT				Realizimi 2010	TOTAL BK + Don.
			Q1	Q2	Q3	Q4		
Rehabilitimi i NS KOS.A -BK	10,334,070	8,882,641	-	31,794	-	1,389,589	1,421,383	10,304,024
Paket Projekti 400/110 kV - Peja 3 (Linja 110 kV & NS Skenderaj dhe Linja 110 kV Klinë)(kfw&BK)	23,343,233	15,734,076	168,233	1,502,320	-	1,859,829	3,530,382	19,264,457
SCADA/EMS & Telekom	17,981,680	10,947,648	-	1,008,972	2,117,429	1,751,123	4,877,524	15,825,172
ITSMO Njehsorët -BK	2,087,955	-						2,087,955
Paket Projekti TS 400/110 kV – Ferizaj 2 (ECLO & BKK)	20,429,500	4,928,466			182,236	1,947,471	2,129,707	7,058,173
Furnizimi dhe instalimi i TR1 në NS Kosova A - BK & KOSTT	2,844,980	2,560,482		171,688			171,688	2,732,170
Instalimi i TR3 150 MVA, NS 220/110 kV - Prishtina 4 KOSTT	2,989,356	2,330,434	658,921				658,921	2,989,355
Linja 400 kV Kosovë-Shqipëri (Kfw + Kredi)	366,639.00	536,639			14,167		14,167	550,806
TOTAL:	80,377,413	45,920,386	827,154	2,714,774	2,313,832	6,948,012	12,803,771	60,812,112

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

	Projekti	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Finalizimi	Kontraktues	Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) rreziku dhe pengesat	Rekomandimet:
1	<i>Projekti i Shërbimeve Konsulente për Rehabilitimin e NS 220/110 kV-Kosova A</i>	453,020.00 €	BKK	453,020.00 €	17.12.2007	16.01.2010	COWI (Dk)	(i.) Edhe përkundër skadimit të kontratës, konsulenca e angazhuar COWI (Dk) është vazhduar me aktivitetet e veta në menaxhimin e projektit në fjalë. Kanë bërë inspektimin e eliminimit të vërejtjeve nga Kontraktori si dhe kanë dorëzuar raportin final të projektit.	
2	<i>Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV - Kosova A</i>	10,334,070.00 €	BKK / KfW	9,881,052.73 €	17.12.2007	16.12.2009	Siemens (At)	(i.) Projekti është nën fazën garantuese njëvjeçare, deri më 27.10.2011.	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 49</i>
Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave		

3	<i>Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	23.343.233,00 €	BKK / KfW	21.562.716,00 € (pa taksa)	10.06.2008	15.03.2010	Siemens & Umel (B&H)	<p>(i.) Afati garantues ka skaduar më nëntor 2010, pjesët tjera të projektit si linjat dhe fushat janë nën periudhën garantuese deri në korrik 2011.</p> <p>(ii.) Projekti ka hasur në pengesa: moslejimi i ndërtimit të shtyllës nr. 1, të linjës 110 kV, që furnizon NS 110/10(20) kV – Skenderaj</p>	<p>Per zgjidhjen e çështjes pronësore juridike me pronarin e tokës (shtylla nr.1e LP 110 kV), rekomandohet që autoritetet e Komunës Skenderaj të përgatisin dhe zbatojnë procedurën e shpronësimit, shpallja objekt me interes të përgjithshëm dhe leja ndërtimore është lëshuar nga ta. Rekomandohet menaxhmenti i lartë i KOSTT-it dhe Komisioni për Projekte Kapitale i BtD të KOSTT-it të aranzhojnë takim të përbashkët me Kryetarin e Komunës së Skenderajt dhe pronarin e tokës, e tëra kjo pas shumë përpjekjesh të pasuksesshme të stafit të Departamentit për M&IP</p>
4	<i>Shtërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	700,000.00 €	ECLO	668,500.00 €	17.12.2009	17.10.2011	INGEDIA (Ro)	<p>(i.) Gjatë kësaj periudhe raportuese konsulenca e angazhuar Ingedia nga Komisioni Evropian (ECLO), ka zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajneve bazike për të dy LOT-at (për nënstacionin NS Ferizaj 2 si dhe për Linjat LP 400 & 110 kV), konform kushteve të kontratës.</p>	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

5	<i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-1:</u> NS 400/110 kV Ferizaj 2</i>	15,800,000.00 €	BKK	13,656,000.00 €	24.12.2009	23.10.2012	SIEMENS (At)	<p>(i.) Projekti është në fazën ku shumica e dizajnëve bazike janë aprovuar. Kontraktuesi ka filluar punimet përgatitore në gërmimin e dheut pas marrjes së pëlqimit urbanistik. Leja Ndërtimore është lëshuar nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit dhe pritet fillimi i punëve ndërtimore gjatë muajit Shkurt 2011.</p>
	<i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-2:</u> LP ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	7,500,000.00 €	ECLO	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	<p>(i.) Projekti është në fazën e punimeve ndërtimore, të cilat fal kohës së përshtatshme janë para planit dinamik që është shumë pozitive. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve implementuese. Është bërë shpronësimi i tokave për linjat 400kV dhe 110kV me Bibaj si dhe është në proces shpronësimi i tokave për linjën 110kV NS. Ferizaj 2 - NS. Gjilani 5.</p>
6	<i>Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë - Shqipëri</i>	1,200,000.00 €	KfW	1,154,620.00 €	24.09.2009	23.05.2010	INTEC (D)	<p>(i.) Konsulenca ka prezantuar trasenë e linjës, dhe draft-tender dosjen e cila pas komentimeve dhe vërejtjeve eventuale është aprovuar nga KOSTT dhe OST, dosja pastaj është aprovuar edhe nga kfW. Në fund të vitit ka filluar procesi tenderues, i cili pritet të përfundojë në fazën e parë tremujore të vitit 2011 pasi data e fundit për dorëzimin e ofertave është 08.03.2010.</p>

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		


7	<i>Shërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS & Telekom</i>	891,541.00 €	BKK	891,541.00 €	15.01.2008	30.10.2010	KEMA (D)	<p>(i.) Nga ana e stafit të konsulencës së angazhuar, janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve instaluese duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në testimet e pajisjeve, si dhe në aprovimin e dizajnit detal për LOT1 si dhe LOT2. Konsulenca ka paraqitur kërkesë për mjete shtesë për shërbimet shtesë, konform kushteve të kontratës pasi që me kontratë nuk është paraparë menaxhimi i instalimit të Mbrojtjeve Rele në TS Prizreni 2 si dhe vonesat e shkaktuara në kontratat e punëve për të LOT-at.</p>	
8	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom</i> <u>LOT-1:SCADA/EMS</u>	8,500,000.00 €	BKK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.10.2010	Areva/Komtel (F/KS)	<p>(i.) Projekti është në fazën e implementimit. Janë aprovuar shumica e dokumenteve, disa janë aprovuar me komente, ndërsa një numër i tyre nuk janë aprovuar. Janë mbajtur mbledhjet e progresit mujor, mbledhje të Komitetit Drejtues si dhe takime koordinuese ndërmjet LOT1 dhe LOT2. Janë realizuar SAT-at për pajisjet e instaluar. Ka filluar implementimi i punimeve në EKCS (Qendren Nacionale Dispecerike Emenrgjente - QNDE) dhe janë mbajtur takimet e rregullta javore dhe janë dërguar gjithsejtë 15 raporte inspektimi. Ka vonesa në projekt dhe këto vonesa janë arsyetuar edhe nga ekipi i menaxhimit të projektit dhe Komiteti Drejtues i Projektit, ku është vendosur që të bëhet shtyrja e afatit të implementimit deri më 31.03.2011.</p> <p>(ii.) Vonesat kryesisht kanë të bëjnë me pamundësinë e sigurimit të qasjes për kontraktuesit në QND dhe QNDE (rindertimi i objekteve nga ana e jone); qasja në nenstacionet në pjesën veriore të Kosovës si dhe veshitësitë në sigurimin e shkrycjeve të stabilimenteve në nenstacionet 110/x kV.</p>	<p>Të zhvillohen aktivitete me instancat relevante për sigurimin e qasjes për kontraktuesin në NS Ujman dhe NS Vallaq, për zbatimin e punëve, konform kontratës</p>

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 49</i>
Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave		

	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom</i> <u>LOT-2: Telekom</u>	9,500,000.00 €	BKK	9,214,760.00 €	31.12.2008	30.10.2010	Enegroinvest/Areva (B&H/F)	<p>(i.) Projekti është në fazën e implementimit. Gjatë vitit 2010 ka vazhduar implementimi i punëve të projektit duke përfshirë: komentimin/aprovimin e dizajneve detale për sistemin e Telekomit, Është punuar në aftësimin e kanaleve komunikuese për Peja 3 dhe Kosova A. Po ashtu, është bërë edhe një vizitë nga ana e Komisionit Pranimi Teknik Intern të KOSTT-it, për 19 linjat me OPGW të përfunduara. Poashtu vazhdon instalimi i OPGW në LP: 205/1, 1139/1, 163, 1139/2.</p> <p>(ii.) Parashihen vonesa për arsye: Qasja për punë në pjesën veimore, Shkyçjet e linjave 110k & 220kV, Pengesat në instalimin e OPGW në LP1139/2, dhe Pengesa në instalimin e shtyllës mbështetëse Nr. 31.</p>	Të zhvillohen aktivitete me instancat relevante për sigurimin e qasjes për kontraktuesin në NS Ujman dhe NS Vallaq, për zbatimin e punëve, konform kontratës
9	<u>LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS. Prishtina 4</u>	3,500,000.00 €	KOSTT	2,214,154.00 €	16.06.2009	15.04.2010	B Petrol & Electroputere (KS/Ro)	<p>(i.) Projekti ka përfunduar dhe është energjizuar më 09.08.2010, komisioni për pranim teknik intern ka pranuar projektin, është lëshuar certifikata për pranim të përkohshëm më 30.08.2010 dhe ka filluar afati garantues njëvjeçar.</p>	
	<u>LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajis. TL në NS. Prishtina 4</u>	800,000.00 €	KOSTT	775,202.37 €	24.07.2009	23.02.2010	SIEMENS (At)	<p>(i.) Projekti ka përfunduar dhe është energjizuar më 09.08.2010, komisioni për pranim teknik intern ka dhënë disa vërejtje, është lëshuar certifikata për pranim të përkohshëm më 30.08.2010 dhe ka filluar afati garantues njëvjeçar. Në ndërkohë kontraktuesi ka bërë eliminimin e shumicës së vërejtjeve.</p>	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

10	Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)	13,000,000.00€ (LOT1&2)	ECLO	634,000.00 €	05.10.2010	11.07.2012	INGEDIA (Ro)	<p>(i.) Procedurat tenderuese nga ECLO kanë përfunduar dhe fitues është shpallur kompania Ingedia nga Romania. Pritet organizimi i takimeve të para me kontraktues (Kick Off Meetings), dhe fillimi me mbikëqyrjen edhe menaxhimin e kontratës.</p>	
11	<i>Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)</i>	13,000,000.00 €	ECLO	6,308,920.00 €	10.01.2011	07.01.2014	KONCAR (CRO)	<p>(i.) Procedurat tenderuese nga ECLO kanë përfunduar dhe fitues është shpallur kompania Koncar-KET nga Kroacia. Pritet mbajtja e takimit të parë fillestar.</p>	
	<i>TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</i>			834,287.00 €	10.01.2011	09.01.2012	Siemens (At)	<p>(i.) Procedurat tenderuese nga ECLO kanë përfunduar dhe fitues është shpallur kompania Siemens nga Austria. Pritet mbajtja e takimit të parë fillestar.</p>	

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Çështjet Rregulative

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, KOSTT ka zhvilluar aktivitetet e saj lidhur me Shqyrtimin e Katërt të Tarifave të Energjisë Elektrike. Kjo nënkupton përgatitjen e Arsyeshmërisë së Kërkesës për të Hyrat e Lejuara, Aplikacionin Preliminar e pastaj edhe atë Final, si dhe Komentet ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së.

Me 24 mars, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka aprovuar tarifën e reja të energjisë elektrike që filluan të zbatohen nga 1 prilli 2010.


Në bazë të Nenit 27.5 të Licencës për Operatorin e Sistemit dhe Transmisionit dhe Nenit 19.5 të Licencës për Operatorin e Tregut, KOSTT ka dërguar në ZRrE Raportet Vjetore mbi pajtueshmërinë me kushtet e Licencave, Raportet tremujore për bizneset e Operatorëve të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Raportin Vjetor mbi realizimin e Planit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (Zotimi i Infrastrukturës).

KOSTT ka dërguar në MEM Raportin mbi Progresin e Implementimit të Planit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës si dhe revidimin e veprimeve dhe planeve financiare ndërlidhëse. Poashtu, KOSTT ka paraqitur konceptin lidhur me kërkesat për mbështetje teknike nga IPA për vitet 2011-2012.

Në tremujorin e dytë, KOSTT është përfaqësuar në Panairin EkoBizExpo në Tiranë dhe ka marrë pjesë në takimin e DSPA-se (Dialogu i Stabilizim Asociimit) që është mbajtur në Bruksel.

Gjatë vitit 2010, KOSTT në bashkëpunim me konsulentët ka vazhduar të bëjë analizë për mundësinë e zgjidhjes së problemit të financimit të projekteve kapitale, që reflektohet nga baza e ulët e aseteve. Në periudhën korrik – gusht është përgatitur dokumenti “Rishqyrtimi i vlerës së aseteve të KOSTT”, i cili paraqet rezultatet e analizave të shumëta lidhur me financimin e aseteve. Propozimet së bashku me konkluzionet përkatëse janë dërguar në ZRrE.


Me Vendimin V_293_2010, të lëshuar nga ZRrE të datës 10 shtator 2010, KOSTT është njohtuar se ZRrE ka aprovuar dokumentin: “**Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010-2019**”, të përgatitur nga KOSTT, i cili do të implementohet nga të gjitha departamentet e KOSTT-it. Plani Zhvillimor i Transmisionit paraqet dokumentin bazë për zhvillimin e rrjetit të transmisionit dhe interkoneksioneve me rrjetet fqinje të transmisionit, me qëllim që të garantohet siguria e furnizimit me energji elektrike. Ky dokument përpilohet në përputhje të plotë me “Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës”.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

Është përgatitur **Raporti për monitorim Intern** të implementimit të Kodeve Teknike, qëllimi i të cilit është identifikimi i obligimeve, në përmbushjen e të cilave paraqiten vështirësi apo pengesa.

Përmes të shkresës të datës 30 dhjetor 2010, KOSTT është njoftuar nga ZRrE lidhur me planin e realizimit të Shqyrtimit të Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE5) që ka të bëjë me tarifat dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2011.

Me datë 22.12.2010 KOSTT ka pranuar nga KEK një njoftim zyrtar me Nr. 593 për refuzimin e pagesave ndaj KOSTT për shërbimet e kryera të transmisionit. Në këtë letër është theksuar se KEK nuk posedon burime financiare për të paguar KOSTT-in për çfarëdo sasi më të madhe se shuma e përfshirë në të Hyrat e Lejuara të aprovuara nga ZRrE. KOSTT i është përgjigjur shkresës së KEK-ut për faturat dhe pagesat për shërbimet e transmisionit duke dhënë sqarime bazuar në legjislacionin në fuqi dhe i ka kthyer mbrapa faturat tek KEK-u.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

2.5. Shqyrtimi i performancës financiare -

2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

31.12.2010

	Note	EUR-2009 EUR 000	EUR-2010 EUR 000
PASURITË JO QARKULLUESE		75,241	87,653
Palujtshmëritë, impiantet dhe pajimet	4	75,195	87,617
Investimet në vijim	5	46	36
PASURITË QARKULLUESE		28,857	32,967
Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat	6	1,016	907
Arkëtueshmëritë dhe kërkesat tjera	7	10,200	10,322
Huatë,avanset dhe depozitat	8	8,504	6,888
Tatimi në të hyra			
Paraja në arkë dhe bilanci bankar	9	9,137	14,850
		104,098	120,620
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT		39,158	42,901
Kapitali aksionar	10	25	25
Kapitali i trashëguar	11	28,347	28,347
Fitimi për periudhën e mëhershur			10,785
Fitimi i mbajtur/ Fitimi i mbajtur/janar-dhjetor/2010		10,786	3,744
DETYRIMET JO KURENTE		57,362	68,685
Të hyrat e shtyera	12	57,362	68,685
DETYRIMET KURENTE		7,578	9,034
pagueshmëritë dhe obligimet tjera	13	7,578	9,034
KONTIGJ.DHE ZOTIME		64,940	77,719
	14		
		104,098	120,620

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 32 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

2.5.2. DRAFT PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJS 31.12.2010

	Note	2009 (EUR 000)	2010 (EUR 000)
Të hyrat operative		21,257	23,430
Të hyrat nga Tarifat	15	20,061	20,076
Të hyrat tjera operative	16	1,196	3,354
Shpenzimet operative		13,746	18,823
Shpenzimet e stafit (pagat)	17	2,283	2,648
Kompensimet tjera	23		88
Materiali harxhues		32	37
Rregullimi sekundar		996	1,600
Amortizimi	4	3,001	6,025
Shpenzimi i energjisë, telefonit dhe ujit		225	226
Riparime dhe mirëmbajtje	18	917	767
Shpenzimi i derivateve dhe lubrifikanteve		79	76
Shpenzimet e shërbimeve	20	197	249
Humbjet e energjisë	21	5,212	4,319
Provizioni i kërkesave kontestuese	22		1,832
Shpenzimet tjera operative	19	804	957
Fitimi para tatimit		7,511	4,607
Tatimi		522	726
Neto fitimi për periudhë		6,989	3,881



RAPORT VJETOR

DT-PB-004

ver. 1.0


faqe 33 nga 49

Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave | Sektori:

Realizimi i projekteve kapitale nga Buxheti i Kosovës gjatë vitit 2010

01.01.2010-31.12.2010

Kodi buxh.	Emri i projekt.	Buxheti i aprovuar	Janar/Mars 2010		Prill/Qershor 2010		Korrik/ Shtator 2010		Tetor /Dhjetor 2010		Totali		Buxheti i pashpenzuar
			Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	
12390-0613/6	<u>11-KOSTT</u> <u>Rehabilitimi i NS Kosova A dhe Shërbime Konsulentësh për NS Kosova A</u>	1,423,188	0	0	31,794	31,794			1,389,589	1,389,589	1,421,383	1,421,383	1,806
12390-0613	<u>12-KOSTT</u> <u>SCADA/EMS Telekomit dhe Shërbime Konsulentësh për SCADA/EMS & Telekomit</u>	5,162,588	0	0	1,008,972	1,008,971	2,117,429	2,117,429	1,751,123	1,751,123	4,877,524	4,877,524	285,064
312401-091537	Paket Projekti Peja 3-Pjesa e ndërtimit të LP dhe S Skenderaj dhe LP 110kV për NS Klinë	1,860,000	0	0.00	1,860,000	1,502,320	0			358,221	1,860,000	1,860,541	-541
312401-091569	Paket Projekti TS 400/110kV- Ferzaj 2	182,236	0	0	0	0	0		182,236	182,236	182,236	182,236	0
		8,628,012		0	2,900,766	2,543,085					8,341,143	8,341,684	286,328

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2010.

Treguesit	I-IX 2009	I-IX 2010	Spjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithësejt të hyrat	0.35	0.15	<p>Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.</p> <p>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.</p> <p>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.</p>
T2. Treguesi i qarkullimit = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese	3.81	3.66	Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është 1.5 .
T3. Mbulimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes: të hyrat e rregull. shp. e mirëmbajtjes	23.16	23.88	Në rastin kur do të realizohej e tërë mirëmbajtja e planifikuar, ky tregues do të kishte vlerën 5.8 (19,561/3,914), që do të ishte rasti ideal.
T4. Mbulimi i shp.operative = gjith.të hyrat/shpenzimet operative	1.54	1.23	Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara Treguesi duhet të jetë më i madh ose = 1


	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

T5. Mbulimi i të hyrave = gjithë të hyrat/ shpenzimet e lejuara	1.18	1.35	Treguesi duhet të jetë më i ulët se 1
T6. Mbulimi i të lejuara = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat	0.85	0.74	Treguesi duhet të jetë më i vogël se 1 ose = 1
T7. Gjithë të hyrat ndaj të lej = gjithë të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara	1.13	1.11	Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara. Treguesi duhet të jetë = 1. Për shkak të rrjedhave më të mëdha të energjisë, treguesi është më i madh se 1.
T8. Qarkullimi i arkëtueshmërisë = gjithësejt të hyrat mesatarja e llog. të arkët.	2.88	2.62	Duhet të jetë 4.1 në mënyrë që të realizohet objektivi (i paraqitur në treguesin më poshtë), që periudha mesatare e arkëtimit të jetë 90 ditë. (365 ditë/4.1)
T9. Periudha mesatare e arkëtimit = $\frac{365 \text{ ditë}}{\text{qarkullimi i arkëtueshmërisë}}$	127 ditë	140 ditë	90 ditë
T10. Shpenzimet e lejuara për km. të rrjetit	15.18 €/km	14.60 €/km	Kosto e shpenz. të lejuara për km të rrjetit është më e ulët krahasuar me vitin paraprak.
T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara	2.16	2.02	Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZrrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 2.02 m €/GWh. Ky indikator gjithashtu analizohet duke iu referuar treguesit T14, që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.22 m €/GWh. Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara	2.12	2.14	Paraqet të hyrat për njësi. Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike
T14. Shpenzimet totale për njësi = shpenzimet totale/GWh e transmetuara	1.65	2.22	Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike.
T15. Detyrimet ndaj aseteve = $\frac{\text{dety. aftshk} + \text{det.afatgjat}}{\text{Gjiths.asetet}}$	0.07	0.07	Qëllimi është që të jetë më i vogël se 1.
T16. Kthimi në asete neto (RONA) = $\frac{\text{fitimi neto}}{\text{Asetet neto}}$	0.08	0.03	Objektivi: të jetë më i madh se mesatarja e industrisë
T17. Treguesi i ekuitetit = $\frac{\text{gjiths.të hyrat}}{\text{kapitali}}$	0.2	0.2	Objektivi: më i madh se 0
T18. Asetet neto = gjiths.asetet-detyrimet	88,942	102,380	Objektivi: Asetet > Detyrimet
T19. CAPEX-i ndaj km. të rrjetit	11.64	16.04	Objektivi: të jetë sa më i madh
T20. Huatë afatgjata ndaj aseteve = $\frac{\text{hua afatgjate}}{\text{gjiths.asetet}}$			Treguesi nuk është llogaritur pasi, gjatë vitit 2010 është paguar vetëm provizionin për kredinë e kfw.

Vërejtje: Indikatorët T5 dhe T14, kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e lejuara bazuar në metodologjinë e tarifave. Për t'u caktuar caku real, duhet të mblidhen të dhënat mbi kostot historike.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		

3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

Nr.	Lënda nr.	Pranë	Objekti i kontestit	Vlera e kontestit	Statusi	Statusi	
1	Lënda Penale nr. 230/03	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	n/a	Palët janë denuar me denime penale (burgim 3 muajsh), pritet ekzekutimi	Lënda me Ankesë, e dorëzuar ne GjQ-Pr.me dt.28.03/07. Rrefuzohet Ankesëa me Aktgjykimin nr.157/07 te dt.22.04.2009.	Lënda kthehet ne contest Civil. Përpilim padisë pas vlerësimit të damit.
2	Lënda Civile nr. 2248/03	Gjykata Komunale në Prishtinë	dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës	92,000.00	Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës	Seanca e caktuar për dt.14.07..2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit Pllan pabazë.Pritet Akgjykimi.	
3	Lënda Penale nr. 232/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	10,100.00	Seanca e rradhës është caktuar që të mbahet më 18.11.2008. Shtyhet, për dt.30.01.2009.	Shtyhet për 27.02/09,Shtyhet për dt.13.03;shtyhet për dt.31.03.09.-shtyhet për 05.05/09.Seanca e rradhës me: dt.14.08/09,11h.	Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 38 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

4	Lënda penale nr.326/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	2,370.00	Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01; shtyhet 30.03.2009...	Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtur Aktgjykimi.-është pranuar, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009)	Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer.
5	Lënda Civile nr.85/05	Gjykata Komunale në Prishtinë	kompensim i ulla	50,000.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008	Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009,	Mbahet ulla i përfundimtare dt.10.02/09; Pritet Aktgjykimi.Verifikimi i fundit me dt.11.06.2009.Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit. Në favor të KOSTT-it. Lënda me Ankesë në GjQ.
6	Lënda penale nr.297/02	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	200	Gjykata e shkallës së dytë	Aktgjykimi është marrë, aprovohet Ankesa e KOSTT-it.Kthehet Lënda në Kontest Civil, për realizimin e ulla .	Kontesti civil ne Gjykatën Komunale në Ferizaj, Padia e dorëzuar me dt.26.06/09.
7	Lënda civile C1.nr.505/07	Gjykata Komunale në Prishtinë	pagesa e kamatës ligjore	nuk ka	Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në ulla i pa prezencën e KOSTT-it.	Është caktuar seanca me dt.01.04.2009,shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010.	Aktgjykimi nuk është i formës së prerë

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

8	Lënda penale nr. 2406/ 06	Gjykata Komunale në Prishtinë	vjedhje	15,398.00	Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm	Nuk kemi njoftim ende për formën e prerë.	Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Paditurve, nga dt.12.06, do t'i dorëzohet me polici
9	Lënda penale nr.320/06	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje e rëndë	9,120.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008	Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi	Aktgjykimi me Ankesë, ne GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010.
10	Lënda penale 284/06	Gjykata Komunale në Lipjan	vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar	KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit)		.Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut.
11	Lënda civile nr.130/07	Gjykata Komunale në Kaçanik	Prerja e drujve	9.340.00	Gjykata e shkallës së lartë ia aprovon kërkesëpadinë e lartë Murteza Dermjanit, KOSTT-i ka ushtruar Ankesë	Aktgjykimi i GjQ.Pr, dt 25.03.2010. Pritet propozimi për Ekzekutim (PpE. Kundërshtim në afatin ligjor.	Rrefuzohet kundërshtimi në.E.162/10, parashtrohet Ankesa në Gjykatën.e shkallës së dytë.Lenda e perfunduar.
12	Lënda civile nr. 409/06	Gjykata Komunale në Prishtinë	Lirimi i banesës	nuk ka	Seanca e rradhës nuk është mbajturur, pritet caktimi i lartë tjetër	Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10(ditë pushimi).	Seanca e rradhës nuk është caktuar ende.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

13	Lënda civile nr. 32/08, me Aktvendim 217/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Prerja e malit dhe hapja e rrugës	5,026.00	Nga dt.22.05/09, Gjykata kërkon Përgjigje në Padi. Është dërgu përgjigja.U mbajt llan i me dt.23.06/09.Gjykata propozon marrëveshje interne mes palëve.	Seanca e rradhës me dt.24.09/09, 12h. Para llan ii palët ndërgjygjëse tentojnë sërish arritje të Marrëveshjes.Dalje në vend me Gjykatën, dt.30.07/09. Gjykimi është kryer, presim Aktvendim.	Lënda me Ankesë në GjQ-Pejë
14	Lënda civile nr. 526/08	Lirimi i lokaleve në Kastriot	lirimi i lokaleve në Kastriot	nuk ka	Pritet caktimi i llan ii kryesore		Ende nuk kemi njoftim për seancën e rradhës
15	Lënda civile nr.511/00	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokaleve në Kurriz	nuk ka	Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë	Aktgjykimi është marrë, në llan ii është propozimi për ekzekutim.	Ende nuk është kryer.(Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda me Ankesë GjQPr.
16	Lënda civile nr. 2168/04	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz	nuk ka	Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008	Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit.	Seanca e rradhës me dt.17.04/09,(Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

17	Lënda civile C.nr.588/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Kompenzim dëmi	1719.04	Seanca u caktua për dt.19.01.2009	Seanca e rradhës në afat të pacaktuar	KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.
18	Lëndë civile, Padi	Gjykata Komunale Prizren	Kompenzim dëmi		I parashtruar me dt.11.03/09.	Pritet caktimi i ðlan ii.	
19	Lëndë Civile C.nr.442/09	Gjykata Komunale- Prizren	Pengim posedi	500	Seanca e caktuar për dt.22.10/09 shtyhet,	Verifikimi i gjendjes faktike në terren, dt.04.11/09	Seanca mbahet dt.11.11/09,11,30h; shtyhet (nuk ka njoftim për seancën e rradhës)
20	Lënda C.nr.625/03	Gjykata Komunale Prishtinë	Eksproprijim		Seanca e dt.18.02.2010	Shtyhet për dt.22.02.2010, 10h	Legjitimiteti pasiv litakon KEK- ut,(deklarata në procesin e ðlan ii të dt.22.02.)
21	Lëndë civile , Padi	Gjykata Komunale Ferizaj	kompenzimi i dëmit	200,00€	Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09	Pritet caktimi i ðlan ii.	
22	C.nr.2331/06	Gjykata Komunale Prishtinë	Kontratë Banesore	n/a	Seanca 18.05.2010	Duhet konstatuar legjitimiteti ðlan paditurës.	Nuk ka njoftim për seancën e rradhës.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

23	G.nr.221/09	Gjykata Komunale – Kaçanik	kompenzimda mi.Sipas Kontrates shpenzimet I bart punekryresi.		Përgjigja në Padi, paraqitur në afat ligjor	Senaca e llan, dt.29.06.2010, shtyhet për 08.07/10	Gjykata cakton dalje në vend për ekspertizë.Seanca kryesore dt.08.10/10;Pritet Aktgjykimi.Lënda e perfunduar
24	C.nr.1559/06	Gjykata Komunale Prishtinë	pagesa e Rentës.		KEK ka paguar – Qershor/2006.	Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10	KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv.
25	C.nr. 270/07	Gjykata Komunale Podujevë	Kompenzim dami	100.000,€	KOSTT- I padituri III-të (Tretë)	seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorzimi I shkresave te lendes KOSTT-it	Seanca e radhes sipas fteses.
26	A.nr.888/10	Gjykata Supreme e Kosoves	Vlersimi per TP	14.000,€	Ankesa e KOSTT-it pjesërisht e aprovuar nga Bordi Komunal.	KA i parashtruar ne afat ligjorë	

Lëndët për të cilat është përfunduar procedura janë:

Lënda civile C.nr.130/07 (Lënda është përfunduar në favor të palës)


Lënda civile C.nr.221/09 (Lënda është përfunduar në favor të palës. Në bazë të kontratës pagesa është refunduar nga kontraktori)

Lënda civile C.nr.1559/06 (Kjo lëndë është kompetencë e KEK-ut, KOSTT ka dhënë dëshmi mbi legjitimitet pasiv)

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

4. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2010 nga burimet e KOSTT

Nr	Dep	proced	Lloji i prokurimit	Emri i prokurimit	KONTRAKTORËT	LOT	Vlera e kontratës	Vlera e realizuar e kontratës	Vlera e parealizuar e kontratës	<u>Kontrata</u>
1	OT	001	Furnizim	Ndërrimi i stabilimenteve të TL në NS "Kosova B" ana 400 kV	SIEMENS		1,275,285.00 €	191,292.75 €	1,083,992.25 €	nr.214 dt.25.06.2010
5	BNJ	005	Sherbim	Mirembajtja e CAS-it	INOVATIVI		190,000.00 €	44,208.50 €	145,791.50 €	nr.133 dt.15.04.2010
16	BNJ	016	Sherbim	Sigurimi shendetesor I puntoreve te KOSTT sh.a.	SIGURIA		137,059.92 €	45,137.67 €	91,922.25 €	nr.180 dt.26.05.2010
18	OT	018	Furnizim	Furnizim me Transformatorë Matës	RIMA ENGINEERING		204,914.28 €	30,737.15 €	174,177.13 €	nr.282 dt.21.19.2010
19	OT	019	Pune	Rindertimi I linjes 110 kV, nr.126/5	Elsa Gornja Radgona		165,416.00 €	129,664.58 €	35,751.42 €	nr.258 dt.01.09.2010
20	OT	020	Furnizim	Ndërrimi i izolatoreve dhe urave percuese ne LP 126/2	UMEL-DALEKOVDMONTAZA		118,059.00 €	118,059.00 €	- €	nr.245 dt.02.08.2010
21	OT	021	Furnizim	Furnizim me mjete punuese per mirembajtjen e linjave	DONA IMPEX		99,999.00 €	46,937.08 €	53,061.92 €	nr.259 dt.02.09.2010
22	OT	022	Furnizim	Furnizim me pjese rezerve per LP	RIMA ENGINEERING		95,000.00 €	28,616.52 €	66,383.48 €	nr.244 dt.26.07.2010
26	BNJ	029	Furnizim	Furnizim me derivate te naftes	PETROL OTI SLOVENIJA		160,000.00 €	48,782.03 €	111,217.97 €	nr.194 dt.01.06.2010
29	BNJ	032	Pune	Renovimi i nivelit 1 dhe përgatitja e tij për implementimin e projektit te SCADA-EMS	AL_TRADE		320,671.97 €	248,669.06 €	72,002.91 €	nr.227 dt.13.07.2010
<u>Totali</u> →							3,262,341.06 €	1,180,875.26 €	2,081,465.80 €	36.20%

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Shtojca 1: Raport mbi funksionimin e Qeverisjes Korporative të KOSTT-it

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2010 në KOSTT janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për implementimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në lidhje me qeverisjen korporative. Ky Raport përfshinë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31,32 dhe 37 të Ligjit për NP janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore.


Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informata rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it.

Gjatë vitit 2010 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur:

- 8 mbledhje të rregullta,
- 3 mbledhje të jashtëzakonshme,
- 1 takim konsultativ.

Komisioni i Auditimit ka mbajtur 7 mbledhje.

Komisioni për projektet kapitale i themeluar nga Bordi për nevojat e KOSTT-it ka mbajtur 3 mbledhje.

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Komisioni për ndajren e asetëve KOSTT-KEK i themeluar nga Bordi ka mbajtur 1 mbledhje dhe disa takime.

Komisioni për linjën 400 kV Kosovë- Shqipëri ka mbajtur 3 mbledhje. Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materialet në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.


Tabela më poshtë përmban një pjesë të aktiviteteve korporative duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrarët Kryesor Financiar, Sekretarët të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me zyrarët e Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitetet e ngjajshme korporative.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet e aprovuara në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.


Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e materialeve si vijon:
1	Raportet tremujore për periudhën Janar –Mars , Prill – Qershor, Korrik-Shtator dhe Tetor-Dhjetor 2009 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP)
2	Deklarata për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrarët e KOSTT (bazuar në nenin 20 dhe 22 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike)
3	Politika e kompensimit për stafin menaxherial me pjesët shtesë: Nivelin e pagave për stafin menaxhues të KOSTT
4	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2010
5	Raporti për implementimin e Ligjit të Ndërmarrjeve Publike për vitin 2009
6	Vendimi mbi vlerën e ndihmës nga KOSTT-i për Shqipërinë me rastin e përmbytjeve
7	Politika për performancën e Bordit dhe zyrarëve (bazuar në nenin 20 dhe 22 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike)

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

8	Raporti Vjetor 2009 dhe Draft Pasqyrat financiare
9	Rregullore e punës së Bordit dhe Komisionit të Auditimit
10	Kërkesë për nënshkrimin e marrëveshjes për themelimin dhe financimin e “Project Team Company” për përgatitjet e nevojshme për themelimin e CAO – (Coordination Allocation Office)
11	Politika mbi Udhëtimet Zyrtare me ndryshime
12	Politika e zhvillimit dhe trajnimit me ndryshime
13	Politika e rekrutimit dhe Politika mbi mundësitë e barbartas të punësimit
14	Politika mbi pirjen e duhanit në vendin e punës
15	Politika mbi Orarin e Punës
16	Politika për pushimet
17	Harmonizimi i vlerës së poenit për stafin jomenaxherial në harmoni me të hyrat e lejuara për vitin 2010 nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë
18	Raporti mbi auditimin e brendshëm të prokurimit në KOSTT
19	Vendimi mbi alokimin e mjeteve nga vija buxhetore „Renovimi i fasadës së objektit me punët përcjellëse në projektin Renovimi i nivelit 1 të objektit dhe përgatitja e tij për implementimin e projektit SCADA/EMS
20	Politika për shitjen me ankand të aseteve të luajtshme dhe materialeve të nxjerrura jashtë përdorimit
21	Politika e IT-së
22	Politika mbi Menaxhimin e Objekteve
23	Politika mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare me plotësime dhe ndryshime
24	Politika e orientimit/njoftimit për punëtorët e rinjë
25	Plani i Biznesit të KOSTT-it për vitin 2011
26	Buxheti për vitin 2011

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

27	Raporti mbi përmbushjen e nevojave të konsumatorëve
28	Propozim i KOSTT-it për materialin reprezentativ të vitit 2010/2011
29	Politika për ndarjen e bursave
30	Politika për shpërblimet dhe mirënjohjet e punëtorëve
31	Plani i Auditimit për vitin 2011, propozuar nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm
32	Plani i Prokurimit për vitin 2011
33	Raporti ligjor i Sekretarit të Kompanisë në lidhje me Kodin e ri Etik dhe Qeverisjen Korporative
34	Raporti ligjor i Sekretarit të Kompanisë në lidhje me ndikimin e Kodit Etik në Strukturën Organizative të KOSTT-it
35	Raporte të tjera sipas dinamikës së punës në KOSTT
36	Manuali i Punëtorëve
37	Manuali i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 48 nga 49</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

CAO – (Coordinated Auction Office) – Zyra për Koordinimin e Ankandëve

DTS (Document Transmittal Sheet) – Fleta Shpërndarëse e Dokumenteve

ECLO – (nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EJL – Evropa Jug-Lindore

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

EMS – Sistemi i Transmisionit i Serbisë

FAT- (Factory Acceptance Test) – Pranimi teknik në fabrikë

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC –Hidro Centrali

IFRS – (nga angl. International Financial Reporting Standards) – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar


IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KD – Komiteti drejtues

KE – Komisioni Evropian

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KESH- Korporata Energjetike Shqipëtare

	RAPORT VJETOR	DT-PB-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 49 nga 49</i>
<i>Departamenti: Zyra e Planifikimit Strategjik dhe Performancave</i>		

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komisioni Qeverisës për Kodet Operacionale

LP – Largpërçuesi

MEM – Ministria e Energjisë dhe Minierave

MR – Mbrojtje Rele

MIE – Ministria e Integritimeve Evropiane

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Management System)
-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë

TMT – Transformator Matës i Tensionit

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë